



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 1844 Prot.

Pogradec, më 27.02. 2019

**VENDIM**

Nr. 24, DATË 22. 02. 2019

**PËR  
MIRATIMIN E AKT MARRËVESHJES SË BINJAKËZIMIT MIDIS  
BASHKISË POGRADEC, SHQIPËRI DHE BASHKISË WISMAR,  
GJERMANI**

Në mbështetje të, shkronjës "b" të pikës 1.5 të nenit 9, nenit 14, shkronjës "gj" të nenit 64 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", pika 1 e nenit 10 të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të autonomisë vendore", Ligjit Nr. 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", Vendimit Nr. 734, datë 9.9.2015 "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë akt marrëveshjen e binjakëzimit, midis bashkisë Pogradec - Shqipëri dhe bashkisë Wismar - Gjermani, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij.
2. Të autorizohet kryetari i bashkisë Pogradec, për nënshkrimin e akt - marrëveshjes.
3. Akt - marrëveshja të hyjë në fuqi, në momentin e konfirmimit ose lejimit nga institucionet përkatëse të të dyja bashkive Wismar dhe Pogradec.
4. Për zbatimin e vendimit ngarkohet, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

**SEKRETAR**

**JURIST**  
**Besjan MEÇO**

**KRYETARI I KESHILLIT**

**Natalja VELO**

**KRYETARI I BASHKISË**  
**EDUART KAPRI**

